



NGJALLJA

Nr. 10 (165) Viti XV i botimit

TETOR 2006

Çmimi 20 lekë

Rumani

Kryepiskopi Anastas nderohet përsëri me titull nderi "Honoris Causa"

U nderua nga Fakulteti Teologjik i Universitetit të Krajovës dhe mori pjesë në 600-vjetorin e rigjallërimit të jetës murgërore të Rumanisë.

Çast nga ceremonia e dorëzimit Kryepiskopit Anastas të titullit të nderit Doktor "Honoris Causa", nga Fakulteti Teologjik i Universitetit të Krajovës.



Nga 21-25 shtator Kryepiskopi Anastas vizitoi Kishën Orthodhokse të Rumanisë, i ftuar nga Patriarku i saj, Fortlumturia e Tij Teoktisti dhe nga Mitropoliti i Oltenias Teofani, për të marrë pjesë në festimet panagjirike të 600-vjetorit të themelimit të Manastirit të Shën Nikodhimit të Tismanës, si edhe për t'u nderuar nga Fakulteti Teologjik i Universitetit të Krajovës me Doktor "Honoris Causa" *. Kjo është e 14-ta herë e nderimit të Kryepiskopit Anastas me këtë titull.

Më datën 21 ai u prit në aeroportin e Bukureshtit nga Patriarku i Rumanisë Teoktisti, nga Mitropoliti i Oltenias Teofani, nga disa hierarkë dhe disa klerikë të tjerë. Pritja ishte mjaft e ngrohtë dhe shumë vëllazërore. Sapo mbërritën në sallën e pritjes së personaliteteve primatët dhanë edhe intervistat e tyre të para përpara medias. Kryepiskopi Anastas pasi shprehu falënderimet për dashurinë e mikpritjen dhe ftesën për kremtimin e Shën Nikodhimit të Tismanës, theksoi se "figura si ajo e Shën Nikodhimit të Tismanës edhe pas 600-vjetësh vazhdojnë të frymëzojnë e bashkojnë orthodhoksët. Ajo që mendoj se është karakteristike për të është ndjesia e tij, se të gj-

thë orthodhoksët në Ballkan duhet të jenë të bashkuar, dhe njëri të mbështesë tjetrin. Dhe ky horizont i hapur i tij është njëkohësisht i lidhur me ndjesinë e thellë shpirtërore që ka jeta asketike. Këto figura na dretojnë edhe në shekullin e ri që është përpara nesh dhe që pritet të futemi në Evropën e Bashkuar. Kisha e Rumanisë, me traditën, rrezatimin e madh dhe organizimin kaq të plotë që ka sot, si dhe me horizontin e hapur drejt Perëndimit, mendoj se do të kontribuojë shumë në këtë Evropë dhe zëri i Orthodhoksisë do të jetë shumë më i fuqishëm dhe më i shquar".

Ndërsa Patriarku Teoktist u shpreh: "Shën Nikodhimi i Tismanës është një shenjt që e nderojnë shumë jo vetëm në Rumani, por edhe në vendet e tjera orthodhokse të Ballkanit. Për këtë arsye Mitropolia e Oltenias dhe Manastiri i themeluar nga ky shenjt organizuan Simpoziumin për nder të tij dhe të gjithë vitin ia dedikuan Shën Nikodhimit të Tismanës. Ndaj jemi shumë të gëzuar që Kryepiskopi i Tiranës dhe i gjithë Shqipërisë na nderoi me (Vijon në faqen 6-7-8)

Vit i bekuar shkollor!

Një bekim i veçantë për Kishën tonë kanë qenë institucionet arsimore të ngritura në këta 15 vjet, me kujdesin e drejtpërdrejtë e financimet bujare të siguruara nga Kryepiskopi Anastas. Ndaj, fillimi i vitit të ri shkollor nuk është vetëm një festë e dijes, por edhe një moment lutjeje e falënderimi për Perëndinë, që me Hirin e Tij bëri të mundur këtë mrekulli.

Kështu, rinisën nga funksionimi 15 përkujdesjet ditore të fëmijëve, të cilave u shtohet kopshti më i ri, ai i Dervicianit. Por nuk mund të lëmë pa përmendur edhe godinën e re të kopshtit të Durrësit dhe shtesën e rikonstruksionin e atij të Tiranës.

Në godinë të re e moderne është edhe shkolla 9-vjeçare "Frymë Dashurie", në Durrës. Ndërsa ajo "Protagonistët", në Tiranë, ka sivjet mjedisë të reja moderne shtesë.

Shkolla e Mesme Kishtare "Kryeqi i Nderuar", në Gjirokastrë, pret sivjet 22 nxënës të rinj, ndërsa mjaft interes ka tërhequr edhe shkolla profesionale e Mesopotamit.

Viti i ri shkollor nisi dhe në Akademinë Teologjike "Ngjallja e Krishtit", në Shën Vlash dhe Institutin e Formimit Profesional "Frymë Dashurie". Dega e Gjirokastrës e këtij instituti sivjet nisi në një mjedis krejt të ri dhe bashkëkohor.

Ecurinë e tyre do ta ndjekim edhe gjatë vitit mësimor, por donim të veçonim një fakt që nuk përmendet shpesh. Atë se nxënësit e Akademisë Teologjike, ata të Shkollës së Mesme Kishtare, konviktoret e Bularatit apo nxënësit nga Shtëpia e Fëmijës "Shpresa", studiojnë me bursa të dhëna nga Kryepiskopi Anastas.

Po ashtu edhe një numër nxënësish në shkollat 9-vjeçare dhe disa fëmijë të kopshteve. Një ndihmë kjo mjaft bujare dhe shumë e konsiderueshme, që bën të mundur studimin për shumë fëmijë, që ndryshe nuk do ta kishin mundësinë e edukimit në këto nivele.

Promovimi i një jete të shëndetshme për fëmijët

Paketat e ndihmës mësimore në shkollat e përfshira në projektet e Diakonia Agapes.



Zyra Diakonia Agapes është zyra sociale, zhvilluese dhe e emergjencës e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë. Ajo është krijuar që në vitin 1992, me bekimin dhe mbështetjen e vazhdueshme të Fortlumturisë së Tij, Krypiskopit Anastas.

Kjo zyrë realizon projekte dhe programe në disa fusha, si: zhvillimi rural i integruar; shëndeti dhe edukimi; kujdesi social.

Një nga projektet që realizohet në kuadër të fushës së “Shëndetit dhe Edukimit” është “Jetë e shëndetshme për fëmijët”. Ai e ka fillimin në vitin 2001, në shkollën 8-vjeçare të fshatit Kalush, rrethi Kavajë. Që prej vitit 2001 e deri më sot projekti është zbatuar në 12 shkolla 8/9-vjeçare të zonave rurale të rretheve Kavajë, Elbasan e Gramsh.

Motoja e projektit është: “Edukim, Informim dhe Veprim”.

Komponenti edukim: përfshin “takimet e shëndetit” dhe bisedat për mjedisin që zhvillohen me nxënësit e këtyre shkollave. “Takimet e shëndetit” përbajnë njohuri për higjienën personale, sëmundjet që mund të merren nga kafshët shtëpiake, higjienën e të parit; etj. Bisedat për mjedisin kanë të bëjnë me rrezikun që mund të vijë nga mbetjet dhe si ato duhen trajtuar, rëndësinë e hapësirave të gjelbra dhe krijimin e tyre, si dhe kontributin që ne duhet të japim për të pasur një mjedis të pastër.

Shumë nga shkollat ku projekti është zbatuar dhe po zbatohet janë larg qendrave shëndetësore. Si rezultat i kësaj prindërit i çojnë fëmijët për vizitë tek mjeku specialist ve-

tëm kur ata kanë probleme shëndetësore tepër të dukshme. Duke parë këtë nevojë në zonat rurale janë ofruar vizita falas për të gjithë nxënësit e shkollave me specialistë të ndryshëm.

Komponenti informim: synon të informojë prindërit dhe stafin mësimdhënës me qëllim që ata të luajnë rolin e duhur në kultivimin e një stili jetese të shëndetshme për fëmijët.

Nga të gjithë stafet mësimdhënës të shkollave është vlerësuar pozitivisht dhe shumë i dobishëm seminari i zhvilluar me ta me tematikë. Për ndihmën e parë në raste emergjente dhe fenomenin e keq-trajtimit të fëmijëve.

Komponenti veprim: ka synuar të kontribuojë në përmirësimin e terreneve sportive dhe atyre të gjel-

bëruara në shkollat ku projekti është zbatuar.

Një nga aktivitetet e projektit është edhe “Shfaqja me maska”, e cila synon të promovojë talentet e shkollës, si dhe të japë një mesazh për rëndësinë që ka higjiena personale dhe e mjedisit për të pasur një jetë të shëndetshme.

Për zbatimin me sukses të projektit në të gjitha shkollat stafi i zyrës Diakonia Agapes ka pasur mbështetjen e zyrave të drejtorive arsimore të zonave përkatëse dhe të drejtorive të çdo shkolle.

Gjatë 5 viteve të realizimit të këtij projekti janë rreth 2500 nxënës dhe 130 mësues që kanë përfutur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga projekti. Gjithashtu përfutues jo të drejtpërdrejtë kanë qenë prindërit e të gjithë nxënësve si dhe komuniteti përkatës.

Gjatë vitit 2006 projekti po zbatohet në tri shkolla të rrethit Gramsh, të fshatrave Drizë, Kukur e Gribë.

Me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor këtyre shkollave iu shpërndanë një paketë ndihme mësimore për rreth 530 nxënës dhe 35 mësues. Ajo ishte e përbërë nga mjete mësimore të nevojshme për nxënësit që ndihmojnë në procesin mësimor. Një mesazh shoqëron çdo paketë, në të cilin promovohen disa nga të drejtat themelore të fëmijëve.

Zyra Diakonia Agapes do të vazhdojë realizimin e këtij projekti edhe gjatë vitit 2007, duke u përpjekur për të sjellë sadopak gëzim dhe buzëqeshje për fëmijët, të cilët jetojnë në zonat rurale nëpërmjet vizionit të saj “Dashuri që bën ndryshime”.

N. Gramo (Përdhiku), K. Josifi

Tryeza e rumbullakët me donatorë

Nga data 28-30 shtator 2006, në mjediset e zyrës “Diakonia Agapes” u zhvillua takimi vjetor me Agjencitë ekumenike të cilat mbështesin financiarisht aktivitetin e Zyrës Sociale, Zhvilluese dhe të Emergjencës të Kishës sonë. Këto agjenci janë anëtare të Këshillit Botëror të Kishave, organizëm ku që prej vitit 1994 është anëtarësuar edhe Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë. Ky takim kishte si qëllim raportimin për realizimin e projekteve gjatë vitit 2005, ecurinë e tyre gjatë vitit 2006, si dhe paraqitjen e planeve për vitin 2007.

Përveç stafit të Diakonia Agapes, i cili paraqiti projektet lidhur me zhvillimin e integruar rural, edukimin shëndetësor të fëmijëve, grave dhe vajzave në zonat rurale apo edukimin e të rinjve dhe personelit shëndetësor lidhur me HIV/SIDA-n, të zbatuar në shumë qytete dhe fshatra të vendit, të

pranishëm për të paraqitur aktivitetin e tyre si edhe planet e së ardhmes, ishin edhe punonjës të Zyrës së Përkujdesjeve Ditore, Zyrës Kombëtare të Rinisë Orthodhokse, si dhe koordinatorë të projektit me të rinjtë e Qytetit Studenti dhe të Zyrës së Fëmijëve.

Si çdo vit, të gjithë pjesëmarrësit sollën në tryezë përvojat e tyre me grupet e synuara, sukseset e arritura, por edhe vështirësitë e hasura. Nuk munguan edhe planet për vazhdimësinë e projekteve, por edhe nisma dhe ide të reja për të ardhmen.

Gjatë kësaj vizite, miqtë nga jashtë Shqipërisë u njohën më mirë me aktivitetin e kryer nga Diakonia Agapes, çka përbën një pjesë të përpjekjeve të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë për zhvillimin e mëtejshëm të vendit, për edukimin e brezit të ri si dhe për ofrimin e përkujdesjes për ata që janë më shumë në nevojë.

Gjirokastrë**Shprehje e kujdesit të veçantë për brezin e ri**

- Një shkollë e re profesionale ka hapur dyert në Mesopotam ndërsa dega e Institutit të Formimit Profesional është vendosur në një godinë bashkëkohore -

Edhe ky vit i ri shkollor filloi me kushte më të mira në institucionet e ndryshme arsimore që janë themeluar nga Kisha jonë Orthodhokse, me nismën, përkujdesjen dhe financimin e Kryepiskopit Anastas. Kjo vlen edhe për institucionet në Mitropolinë e Shenjtë të Gjirokastrës. Dhe nuk janë të pakta.

Ato janë shprehje të kujdesit të veçantë të Kryebariut tonë për të zbatuar ide sa më progresiste për arsimimin dhe përgatitjen e brezit të ri të vendit, me standarde sa më bashkëkohore. Nisma të tilla në sektorin e arsimit e kanë bërë Kishën Orthodhokse faktor zhvillimi dhe përparimi për gjithë vendin.

Kështu, për të tetin vit radhazi hapi dyert Shkolla e Mesme Kishtare “Kryqi i Nderuar”, një prani e bekuar e Kishës sonë për të ndihmuar të rinjtë orthodhoksë, në

mënyrë që në të ardhmen të bëhen kuadro të denjë të Kishës sonë. Në kushte edhe më të përmirësuara nga pikëpamja e godinave dhe infrastrukturës së mësimdhënies, plot 65 nxënës nga të gjitha mitropolitë e Kishës sonë, të gjithë me bursë të dhënë nga Kryepiskopi, fillojnë edhe një vit përpjekjesh për arsim, por edhe për beteja shpirtërore.

Shkolla “Kryqi i Nderuar” në gjithë ecurinë e saj tetëvjeçare dëshmon dhe justifikon sakrificën për ta krijuar dhe mirëfunksionuar. Dhjetëra të rinjë nga zona të thella, u jepet mundësia e arsimimit në standarde të avancuara, por edhe njëherësh u krijohet përvoja e jetës së përbashkët kristiane, një përvojë që do t’u jetë shumë e dobishme në ecurinë e jetës së tyre. Rezultatet e nxënësve që kanë përfunduar mësimet këtu, pasi shu-

mica e tyre dërmuese ndodhen në universitete brenda dhe jashtë vendit (lidhur gjithmonë me faktin se kudo që ndodhen ata nuk kanë shkëputur kontaktin me aktivitetin shpirtëror dhe kishtar), tregon se shkolla ndodhet në rrugë të mbarë. Lutjet jo vetëm të nxënësve, kolektivit mësimdhënës dhe ndihmës, por edhe të dhjetëra familjeve që kanë fëmijët e tyre atje, përbëjnë mbështetje thelbësore për të ecur edhe më tej.

Sivjet, me masat e reja të marra nga Kisha dhe drejtorja e shkollës synohet, në veçanti në organizimin më të mirë të aktivitetit jashtëmësimor të nxënësve, në mënyrë që kjo të përdoret akoma më mirë për aftësimin e tyre dhe afirmimin e shkollës si një faktor i rëndësishëm social në mbarë trevën në të cilën zhvillon veprimtarinë.

Mbi 150 vogëlushë do të ndjekin

këtë vit përkujdesjet ditore që ka krijuar Kisha jonë në qytetet e Mitropolisë së Gjirokastrës. Konkretisht, filluan kopshtet në Përmet, në të dyja qendrat e qytetit të Gjirokastrës, si edhe në Sarandë. Ndërkaq këtë vit shkollor filloi përpjekja edhe për një kopsht fëmijësh në fshatin Dervician. Kjo si një kontribut i veçantë i Kishës sonë për t’u përgjigjur problemeve të fëmijëve nëpër fshatra ku jeton kryesisht komuniteti etnik grek. Si rrjedhojë e mungesës së numrit të nevojshëm të fëmijëve në shumë nga këto fshatra janë mbyllur kopshtet publike. Kështu me këtë nismë të Kishës Orthodhokse mbi 20 fëmijëve, që do të ishin të privuar nga e drejta për arsim parashkollor, u krijohet kjo mundësi. Përbën edhe kjo një kontribut të Kishës sonë në zbutjen e

(vijon në faqen 4)

Viti i ri mësimor 2006-2007**me ambiente të reja dhe me një staf pedagogjik të kualifikuar**

Në dy shkollat 9-vjeçare të Kishës sonë, “Protagonistët” në Tiranë dhe “Frymë dashurie” në Durrës, atmosfera e gëzuar e nisjes së vitit të ri arsimor u shoqërua edhe me një dhuratë të veçantë nga Kryepiskopi Anastas. Për këto shkolla, përveç stafit të kualifikuar dhe mjeteve didaktike janë siguruar mjedise të reja dhe bashkëkohore për zhvillimin cilësor të mësimt. Për klasën e katërt dhe të pestë në shkollën “Protagonistët” pranë qendrës së re shpirtërore-arsimore të Kishës sonë “Thavor” është kompletuar ndërtesa e re dhe moderne, e cila do të funksionojë posaçërisht për klasat e reja. Edhe në shkollën “Frymë dashurie” në Durrës është bërë rikonstrukcioni i plotë i ambienteve.

Drejtoresha e shkollës shqiptaro-amerikane “Protagonistët”, znj. Polin Rasëll, tha ditën e parë të fillimit të vitit të ri mësimor se “kushtet moderne dhe mësim-



Nxënës dhe mësues të shkollës 9-vjeçare “Frymë Dashurie”, Durrës në ditën e parë të shkollës.

dhënia janë në dobi të ngritjes së mëtejshme formuese të nxënësve, të cilët gjejnë në këtë shkollë të gjitha shërbimet e nevojshme.” Vlen të theksohet se edhe pse është në vitin e pestë të funksionimit të saj, shkolla “Protagonistët” konsiderohet një nga qendrat arsimore më konkurruese në kryeqytet.

Gjithashtu, në këtë linjë ndodhet edhe shkolla e re “Frymë dashurie”

në Durrës, e cila ka hyrë në vitin e dytë të jetës së saj. Atë e frekuentojnë shumë nxënës nga qyteti dhe rrethinat e tij. Shërbimi që iu ofrohet nxënësve të klasës së parë dhe të dytë është me nivele të larta dhe bashkëkohore.

“Për ne, ky vit i ri shkollor sjell dy evenimente: e para është shkolla e re, një dhuratë shumë e bukur e Kryepiskopit Anastas për qytetin

e Durrësit dhe së dyti është nisja e një viti të ri me objektiva të rinj, për të ngritur gjithnjë e më shumë nivelin e përgatitjes së nxënësve”, - tha drejtori i shkollës z. Kristaq Milo. Gjithashtu ai tha se stafi pedagogjik i kësaj shkolle kishte përgatitur një letër falënderimi për Kryepiskopin Anastas.

I.K.

(vijon nga faqja 3)

problemeve sociale.

50 nxënës të reja edhe këtë vit shkollor janë pritur në Konviktin Orthodhoks të Vajzave, që për vitin e gjashtë funksionon në fshatin Bularat. Nxënëset, bursiste të Kryepiskopit, vazhdojnë mësimet në shkollën e mesme publike në këtë fshat duke i dhënë një motiv më shumë ekzistencës dhe mirëfunksionimit të saj. Privilegj përbën për të gjitha të rejtat qëndrimi në këtë konvikt, jo thjesht si një mundësi për ndjekjen e mësimave, por edhe për faktin se në konvikt janë përfituese të një seri njohurish që marrin, jetës kristiane që përbën bekim të veçantë, dhe mundësive të tjera. Në konvikt kanë mundësinë të mësojnë gjuhë të huaja, kompjuter, jetë kristiane. Bëjnë ekskursione në vende të ndryshme, monumente kulturore dhe natyrore. Ajo që është shumë e rëndësishme të theksohet është fakti që këtyre të rejave u jepet një mundësi unike që gjithçka që mësojnë e përfitojnë ta ndajnë me të tjerët: kjo në sajë të kurseve të katekizimit dhe punës me fëmijët

Shprehje e kujdesit të veçantë për brezin e ri

e grupeve që vajzat krijojnë në fshatrat e zonës përreth.

Ndërkaq, Instituti i Formimit Profesional, i cili prej katër vjetësh funksionon në Gjirokastrë, këtë vit transferohet në kompleksin madhështor dhe bashkëkohor arsimor "Emaus". Është një hap i rëndësishëm që do ta shndërrojë këtë institucion në një qendër që do ndikojë ndjeshëm në gjallërimin e veprimtarive arsimore e kulturore përtej procesit rreptsisht mësimor. Godina mbi 3500 metra katrore është një kompleks që plotëson të gjitha kushtet për qëllimin të cilit do t'i shërbejë. Bëhet fjalë

për kompleksin arsimor më modern në të gjithë vendin.

Sivjet Instituti i Formimit Profesional ka për synim të vet edhe tri degë të reja me objekt direkt teknik: për instalime hidraulike, instalime elektrike dhe riparim automjetesh.

Në sektorin e arsimit profesional sivjet Kisha jonë ndërmori edhe një hap tjetër të guximshëm dhe të bekuar njëherësh. Në fshatin Mesopotam të Sarandës u çel dhe filloi nga procesi mësimor shkolla e mesme profesionale "Apostull Pavli". Bëhet fjalë për një institucion tjetër në zinxhirin e

institucioneve të Fondacionit "Frymë Dashurie".

Shkolla ka këtë vit katër degë: informatikë, instalime elektrike, instalime hidraulike dhe instalime frigoriferike-kondicionimi. Janë regjistruar dhe ndjekin mësimet 58 nxënës nga zona e Sarandës, Delvinës dhe Gjirokastrës. Bëhet fjalë për një kontribut të veçantë të Kishës Orthodhokse, ngaqë sistemi profesional përbën synimin e këtij dhjetëvjeçari në vendin tonë. Duke marrë parasysh faktin se në këtë shkollë kanë ardhur kryesisht nxënës me prirje teknike, por me nota të ulë-

ta, kjo ndërhyrje i merr këta nxënës dhe i integron me dinjtet në tregun e punës dhe në shoqëri.

Janë marrë të gjitha masat për pedagogë të kualifikuar (kanë ardhur madje ndihmës me përvojë të gjatë në këtë fushë edhe nga Greqia), për laboratorë dhe transportin e nxënësve. Përveç një kontributi për zhvillimin e arsimit, kjo ndërhyrje ka për të luajtur rolin e saj edhe në zhvillimin e ekonomisë, ngaqë synimi është të nxjerrë profesionistë të përgatitur me metodat bashkëkohore, por edhe njerëz me ideale dhe ambicje progresiste.

Nga një pikëpamje tjetër e gjithë kjo prani e Kishës Orthodhokse në sektorin e arsimit, veç të tjerash, ofron mundësi punësimi direkt dhe indirekt për dhjetëra arsimtarë dhe personel ndihmës, si dhe plotësim në të ardhurat për ata që japin mësim në sektorin publik. Kjo, në zona të periferisë, larg qyteteve të mëdha, përbën akoma më shumë një kontribut të guximshëm dhe frytet e përpjekjes janë më të pëlqyera.

O. Beci



Shkolla i ka të gjitha premiset për të përgatitur të ardhmen

- Intervistë me drejtorin e shkollës "Kryqi i nderuar", z. Thanas Bej -

Cilat janë objektivat për këtë vit të ri shkollor?

Nën kujdesin e Kryepiskopit Anastas prej 8 vitesh funksionon Shkolla e Mesme unike Kishtare në Gjirokastrë. Funksionon duke synuar që të kontribuojë në radhë të parë në edukimin e nxënësve të saj, për integrimin e tyre si anëtarë të denjë të shoqërisë, si dhe përgatitjen e kadrove të aftë për nevojat dhe kërkesat e ndryshme të Kishës. Origjina e nxënësve nga krahina të ndryshme, nga qyteti dhe nga fshati, sjell si rezultat përparimin në nivele të ndryshme për sa i përket formimit kulturor e shkencor të tyre. Objektivi i shkollës edhe për këtë vit të ri arsimor do të jetë krijimi i premisave të përshtatshme për një nivel të lartë kulturor e shkencor, për të gjithë nxënësit pa përjashtim.

Çfarë kushtesh u ofrohen nxënësve?

Kushtet janë mjaft të mira. Shkolla ka një konvikt komod me të gjitha premiset që i duhen një nxënësi. Gjithashtu konvikti disponon salla shumëfunktionale. Edhe ambientet e tjera janë shumë të përshtatshme, si: kuzhina dhe mensa me ushqim cilësor. Shkolla disponon ambiente të përshtatshme për studim dhe të gjitha këto do sigurojnë arritje për të realizuar objektivin e shkollës. Mendojmë se edhe futja e internetit

në shkollë do luajë një rol të rëndësishëm. Ne disponojmë një klasë me kompjutera të rinj, të cilët janë në dispozicion të nxënësve, të cilët kanë arritur të fitojnë aftësi në lidhje me këtë drejtim.

Si paraqitet stafi pedagogjik?

Stafi pedagogjik është i specializuar. Të gjithë kanë shkollën e lartë dhe disa prej tyre kanë grada shkencore. Janë mësues të kualifikuar dhe mundohen që të japin mësim me një nivel mjaft të lartë. Shkolla disponon një bazë materiale aktive dhe laboratorë të cilët përdoren nga vetë mësuesit.

Çfarë thirrje do t'u bënit nxënësve të ardhshëm për të ndjekur studimet në këtë shkollë?

Krahas anës shkencore ku shikojmë që të gjithë nxënësit marrin një formim të mirë, drejtimi tjetër i shkollës është edhe përgatitja morale dhe fetare që ata të jenë njerëz të aftë për Kishën dhe shoqërinë në përgjithësi. Prindërit dhe vetë fëmijët le ta shikojnë me seriozitet këtë shkollë, e cila i përgatit në mënyrë cilësore për të ardhmen e tyre vejtjake dhe sociale.

Intervistoi Isidor Koti

Bosnje

Të rinjtë Orthodhoksë shqiptarë në Asamblenë Ballkanike

Nga 17-23 gusht, në Třebinjë të Bosnje-Hercegovinës u zhvillua Asambleja e Përgjithshme e Federatës Rinore Orthodhokse Ballkanike. Qëllimi i kësaj asambleje ishte zgjedhja e bordit të ri për 4-vjeçarin e ardhshëm. Me bekimin e Fortlumturisë së Tij, Kryepiskopit Anastas, në këtë aktivitet Kisha jonë u përfaqësua nga 13 të rinj të shoqëruar nga atë Ilia Mazniku. Ditën e parë u bë prezantimi i grupeve pjesëmarrëse. Më pas u lexua fjala përshëndetëse e Tërëshenjterisë së Tij, Patriarkut të Konstandinopojës, si dhe e kryehierarkëve të tjerë.

Ky aktivitet u organizua nën kujdesin e Hirësisë së Tij, Athanasit, si dhe Hirësisë së Tij Ireneut, peshkopë të Bosnjës dhe Hercegovinës,

Bosnje-Hercegovinës, i cili shprehu kënaqësinë për organizimin e kësaj asambleje në vendin e tij.

Dita e dytë do të fillonte me lutjen e mëngjesit, ku të gjithë mund të psalnin në gjuhën e tyre e gjithashtu të mësonin disa lutje të shkurtra në gjuhën e vëllezërve e motrave më Krishtin, që vinin nga vende të tjera. Pas shërbesës së mëngjesit u mbajt referati i parë nga z. Jani Zervos, sekretar i Federatës Rinore Orthodhokse Ballkanike. Ai bëri një përmbledhje të aktiviteteve që kjo organizatë kishte kryer gjatë 4 viteve të fundit. Si një nga aktivitetet më mbresëlënëse dhe më të arritura, ai përmendi Konferencën Ballkanike që u organizua në Shën Vlash të Durrësit, në gusht të vitit 2004.

fytyrimin e Zotit Krisht. Ishte me të vërtetë një panair ku të gjithë festonin dhe nderonin këtë ditë të madhe. Gjatë ditës në vazhdim u zhvillua një litani në të gjithë qytetin. Të gjithë njerëzit të veshur bukur, me veshje tradicionale të vendit të tyre, me psalme e himne ecën rreth e rrotull qytetit duke lavdëruar Perëndinë për çdo gjë që kishte sjellë në jetën e tyre. Disa të rinj nga Shqipëria dolën me veshjet tona tradicionale, dhe u nderuan duke mbajtur ikonat e duke udhëhequr këtë litani.

Ditët në vazhdim do të fokusoheshin në prezantimin dhe zgjedhjen e kandidatëve të rinj për bordin e kësaj organizate. President u zgjodh Dmtar Tasic, përfaqësues nga Serbia. Sekretar i përgjithshëm u rizgjodh Jani

Çast nga mbledhjet e Asamblesë së Federatës Rinore Orthodhokse të Ballkanit



nës. Në fjalën e tyre përshëndetëse ata përmendën rolin e madh që luan kjo organizatë, si dhe kontributin e gjerë që jep në përcimin e paqes dhe dashurisë midis shteteve ballkanike. Gjithashtu, ata theksuan shembullin konkret që Federata Rinore Orthodhokse Ballkanike transmeton për mbarrë njerëzimin, duke vënë në qendër dashurinë e Perëndisë dhe unitetin që kanë kishat orthodhokse në Ballkan. Në këtë asamble, përshëndeti edhe presidenti i

Më pas u bë një prezantim i shkurtër i organizatave rinore të cilat donin të bëheshin anëtare të Federatës Rinore Orthodhokse Ballkanike. Mbasditja do të fillonte me referatin e mbajtur nga peshkop Athanasi me temë: “Domethënia e Shpërftyrimin të Zotit për ne të Krishterët Orthodhoksë.”

Kjo ishte edhe tema kryesore e kësaj asambleje. Kjo temë ndërthurej mjaft bukur, pasi të nesërmen i gjithë qyteti do të festonte Shpër-

Zervos, përfaqësues nga Greqia. Në katër vitet e fundit, Shqipëria në këtë bord është përfaqësuar nga Marina Marini, e cila u rizgjodh zëvendëspresidente e tij.

Gjithashtu Shqipërisë iu caktua edhe vendi i sekretarit rajonal, i cili do të zgjidhet në mbledhjen e ardhshme të këtij bordi, që do të mbahet në Varna të Bullgarisë, në datat 6-8 tetor 2006.

M. M.

Në Llogara për mbrojtjen e natyrës



Të gjitha Zoti i bëri me dashuri dhe në shërbim të njeriut. Ndonëse ne njerëzit jemi krijesa më e përkryer, kemi për detyrë t'i respektojmë të gjitha krijesat e tjera dhe të marrim pjesë së bashku në adhurimin e Krijuesit.

Ky ishte mesazhi kryesor që doli nga veprimtaria sensibilizuese e organizuar në mes të shtatorit në Parkun Kombëtar të Llogarasë me të rinjtë Orthodhoksë shqiptarë. Rreth 50 aktivistë të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë nga dioqezat e Tiranës dhe Beratit, si edhe 15 fëmijë të ardhur nga fshati Novoselë i Vlorës, përgjatë tri ditëve ndanë së bashku një përvorje të rëndësishme në dobi të ndërgjegjësimit të përbashkët për kujdesin ndaj mjedisit. Ky aktivitet u organizua nga Kisha jonë me mbështetjen financiare të fondacionit “World Vision” në natyrën e bukur të Llogarasë, e cila vitet e fundit është ndotur së tepërmi nga papastërtitë dhe keqpërdorimi i qytetarëve. Pikërisht për të dhënë një shembull të krishterë dhe për të treguar se kemi përgjegjësi të madhe për t'u kujdesur për të gjithë krijimin, të rinjtë orthodhoksë u organizuan në një ditë të veçantë të këtij aktiviteti, duke pastruar një hapësirë të ndotur të këtij parku.

Si duhet të bashkëjetojnë të krishterët me gjërat e krijuara nga Perëndia, me natyrën, me kafshët? Cila është përgjegjësia e njeriut? Këto ishin disa nga pyetjet e temës qendrore “Bashkëzistencë me krijimin”, e cila u diskutua nga vetë të rinjtë, të cilët shprehën mendime të ndryshme dhe të vlefshme për të ndërgjegjësuar njëri-tjetrin, dhe mbarë shoqërinë se natyra shqiptare po lihet në harresë dhe duhet më shumë përkujdes ndaj saj, ashtu sikurse na tregohet edhe në Gjenezë: “Perëndia në fillim krijoi qiellin dhe gjithë krijesat që ekzistojnë në to”. Kjo tregon qartë se jeta e njeriut s'mund të kishte kuptim pa to. Në librin e krijimit thuhet që Zoti i dha bimët njeriut për t'u ushqyer me to. Njeriu ndihet më i afërt me Perëndinë kur ndodhet në mes të veprës së duarve të Tij. Krijimi është pjesë e rëndësishme e jetës së njeriut.

Gjithashtu, në këtë aktivitet të rinjtë morën pjesë edhe në shërbesat fetare të organizuara gjatë tri ditëve dhe në veprimtari kulturore e sportive, si dhe në biseda sociale rreth natyrës shqiptare dhe kontributit që duhet të japë gjithsecili për mbrojtjen e mjedisit.

Korresp. i gazetës
“Ngjallja”

Kryepiskopi Anastas nderohet përsëri me titull nderi “Honoris Causa”



Çast nga Liturgia Hyjnore me rastin e 600-vjetorit të rigjallërimit të jetës murgërore në Rumani.

(vijon nga faqja 1)

ardhjen e tij në këtë aktivitet të madh. Ai përfaqëson jo vetëm një Kishë Orthodhokse Autoqefale, por edhe kulturën e teologjinë orthodhokse botërore...”

Më pas, Kryepiskopi i shoqëruar nga atë Spiridhon Simandiri dhe hierodhjakon Asti Bakallbashi udhëtuan drejt Krajovës, ku pas disa orëve udhëtimi në darkë u prit në kishën e qendrës Mitropolitane me rënien e kabanave dhe me qirinj në duar nga klerikët dhe murgeshat. Pas përshëndetjeve të rastit për mirëseardhjen dhe mikpritjen u shtrua një darkë në Selinë e Mitropolisë së Oltenias, në Krajovë.

Të nesërrnen, më datë 22 në mëngjes, erdhën mitropolitë dhe episkopë lokalë të krahinave jugore dhe jugperëndimore të Rumanisë për të takuar Kryepiskopin Anastas dhe për të marrë pjesë në ceremoninë e dhënies së titullit “Honoris Causa” nga Fakulteti i Teologjisë i Universitetit të Krajovës. Ceremonia filloi me përshëndetjen e Rektorit të Universitetit z. Mircea Ivanescu, dhe në vazhdim episkopi Irine Popa prezantoi biografinë e Kryepiskopit Anastas, duke pasuar me një minutazh filmik rreth veprës apostolike në Afrikë dhe Shqipëri. Më pas Kryepiskopi Anastas mori fjalën dhe mbajti kumtesën me temë: “Orthodhoksia në Evropën e Bashkuar ndërftetare” (lexoni në numrin e ardhshëm të gazetës). Kumtesa, që pati jehonë shumë të madhe tek pjesëmarrësit universitarë, klerikë e laikë, u ndoq me shumë interes e vëmendje. Pas duartrokitjeve të shumta të pjesëmarrësve rektori i dorëzoi Kryepiskopit diplomën e titullit.

Kjo ceremoni përfundoi edhe me një koktejl për të pranishmit.

Pas ceremonisë Mitropolit Teofan shtroi një drekë në Selinë Mitropolitane të Krajovës, për të nderuar Kryepiskopin Anastas për titullin që iu akordua. Morën pjesë rektori i Universitetit,

Fortlumturia e Tij Kryepiskopi Anastas është një zë i ndritshëm, i shquar, besnik, i mbushur me përlësi. Misioni i tij i madh është një fjalë bindëse që bazohet në jetën më Krishtin, në fjalën e Perëndisë, duke e përçar në vende që nuk mundeshin dot ta dëgjonin këtë fjalë, në xhunglat e Afrikës... dhe duke vazhduar veprën apostolike me bagazhin e tij shkencor, universitar, baritor, teologjik ia doli mbanë edhe në Shqipëri, ku nuk ekzistonte më jeta kishtarë, që fjala e Perëndisë të dëgjohej, të bëhej e kuptueshme dhe e nderuar...

dekani i Fakultetit Teologjik, mitropolitë e episkopë të Sinodit të Shenjtë të Rumanisë etj., profesorë të Senatit të Universitetit, autoritetet lokale të Krajovës, si edhe dekani i Fakultetit Teologjik të Bukureshtit, z. Konstantin Koman etj. Mitropolit Teofan theksoi se “Fortlumturia e Tij Kryepiskopi Anastas është një zë i ndritshëm, i shquar, besnik, i mbushur me përlësi. Misioni i tij i madh është një fjalë bindëse që bazohet në jetën më Krishtin, në fjalën e Perëndisë, duke e përçar në vende që nuk mundeshin dot ta dëgjonin këtë fjalë,

në xhunglat e Afrikës... dhe duke vazhduar veprën apostolike me bagazhin e tij shkencor, universitar, baritor, teologjik ia doli mbanë edhe në Shqipëri, ku nuk ekzistonte më jeta kishtarë, që fjala e Perëndisë të dëgjohej, të bëhej e kuptueshme dhe e nderuar, dhe ajo që është e rëndësishme është se shumë njerëz dëgjuan dhe ndoqën fjalët e Kryepiskopit. Dhe me të vërtetë fjala e Tij bazohet në përpikmërinë shkencore, në analiza dhe pikësëpari në përvojën e shembullin personal. Ai përjetoi dhe përjeton predikimin e Ungjillit brenda ngjitjes drejt Krishtit si përvojë personale dhe e jeton sigurisht këtë me gëzim, dhimbje, përlësi, me jetë asketike, realitet, ku ne e kuptuam dhe fjala e tij na bindi, ia doli mbanë dhe ia del mbanë të lidhë vazhdimisht njohjet universitare me jetën e Kishës”.

Më pas përshëndeti edhe Kryepiskopi ynë, duke falënderuar Mitropolitin dhe përpjekjen e të gjithë atyre që punojnë dhe kontribuojnë në zhvillimin e Kishës Orthodhokse të Rumanisë: “E vetmja gjë që mund t’ju them për identitetin tim është se unë jam një vëlla i juaj, që besoj në unitetin e Kishës Orthodhokse, ku Kishat Orthodhokse në vende të ndryshme nuk janë një konfederatë Kishash, por është një Kishë, e Shenjtë, Katholike dhe Apostolike. Çdo gjë që i ndodh dikujt ka pasoja tek të gjithë. Unë e ndiej gëzimin tuaj si gëzimin tim dhe gëzohem veçanërisht për këtë, për aq sa shoh dhe ndjek...”. Me bashkëpunimin dhe bashkëveprimin e orthodhoksëve: në ndarjen e besimit me të tjerët, ndihmën për njëri-tjetrin, kemi mundësinë ta shumëfishojmë atë pasuri

që na dha Perëndia: “Kjo është për të gjitha marrëdhëniet njerëzore, për familjen, për komunitetin, pra ajo që marrim dhe e mbajmë për vete e humbim, por kur e ofrojmë e shumëfishojmë. Pra Kisha Orthodhokse në epokën e sotme në Evropë duhet të pushojë së qeni një geto, duhet të bëjmë një dalje, dalje me kuptimin ungjillor do të thotë apostullim, mision, të dalim nga vetja jonë. Krishti nuk tha që të shijojmë kënaqësinë e Tij, por ftoi dhe pastaj dërgoi. Dalje do të thotë rrezik, nuk është e lehtë të ndihesh në ambiente të tjera, por dalje do të thotë edhe liri, dhe sidomos besim ndaj Atij që na dërgoi. Unë besoj se lulëzimi i Orthodhoksisë do të vijë me dy krahë: me praninë e jetës murgërore, por gjithashtu edhe me një prezencë të gjallë apostullimi. Të mos këmbëngulim të fluturojmë vetëm me një krah, sado që mund të jetë e mundur dhe e bukur. Uroj që Kisha e Rumanisë të jetë gjithnjë pararojë e evoluimeve në Rumani edhe në Evropë”.

Pasdite Kryepiskopi vizitoi një vëllazëri murgeshash pranë kishës katedrale “Kryeengjëjt Mikael dhe Gabriel” të Krajovës, ku u njoh me punën e tyre të veçantë sociale, edukative kishitare me fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit, trajnim katekistësh, kurse trajnimi, edukimi social dhe psikologjie etj., si dhe komunikimi i tyre nëpërmjet internetit me të rinj që kërkonin të dinin rreth besimit dhe jetës orthodhokse, udhëzimeve shpirtërore e edukative. Me të vërtetë ishte një vëllazëri motrash shumë e gjallë dhe e gjendur në problemet e ndihmën sociale të komunitetit të Krajovës. Shembull me të vërtetë i zellshëm e aktiv ishte nëna e tyre, igumene Siluana, që kishte një ndjesi të madhe, horizont mjaft të gjerë e të thellë. Në mbrëmje në Teatrin Kombëtar “Marin

Soresku” të Krajovës u dha programi artistik me rastin e 600-vjetorit të fjetjes së Shën Nikodhimit (1406-2006), program i përgatitur nga aktorët profesionistë të teatrit me recitime,

...Duhet të bëjmë një dalje, dalje me kuptimin ungjillor do të thotë apostullim, mision, të dalim nga vetja jonë. Krishti nuk tha që të shijojmë kënaqësinë e Tij, por ftoi dhe pastaj dërgoi. Dalje do të thotë rrezik, nuk është e lehtë të ndihesh në ambiente të tjera, por dalje do të thotë edhe liri, dhe sidomos besim ndaj Atij që na dërgoi. Unë besoj se lulëzimi i Orthodhoksisë do të vijë me dy krahë: me praninë e jetës murgërore, por gjithashtu edhe me një prezencë të gjallë apostullimi.

këngë, poezi, dialogje shpirtërore, poema, të psalura kishitare bizantine nga kori 50-vetësh i Dioqezës, një film për manastirin e shenjtin. Në fund përshëndetën Mitropoliti Teofan dhe Kryepiskopi Anastas.

Të nesërmen, më 23 shtator, programi ishte edhe më i ngjeshur. Kryepiskopi dha një intervistë në Televizionin Kombëtar Rumun TVR e më pas u vizitua qendra e Mitropolisë, kisha-historike të qytetit, monumente në qytetin Tagu Jiu etj. Në Manastirin e Shën Nikodhimit të Tismanës Kryepiskopin e pritën në hyrje të gjitha murgeshat, me ceremoninë kishitare të pritjes së një hierarku të lartë: me himnin “Kryezotin dhe Kryepiftin...”, si dhe episkopi i zonës

Nikodhimi me Ungjill bashkë me klerikët dhe besimtarët e ardhur në prag të kremtimit madhështor. Pas pritjes u bënë përshëndetjet dhe u shtrua dreka e rastit. Pasdite mbërriti edhe Patriarku Teoktist, të cilit iu bë e njëjta pritje, duke pasuar në vazhdim me disa aktivitete, njëri prej të cilëve ishte edhe simpoziumi për jetën murgërore, vendosur nga Sinodi i Shenjtë i Rumanisë, ku u bë edhe promovimi i librit të Mitropolitit të Nafpaktos Hierotheu, i ftuar në këtë kremtim, përkthyer në rumanisht.

Ishte me të vërtetë një takim historik sepse u mbledhën për herë të parë përgjegjësit e jetës murgërore të Rumanisë. Në fund të promovimit Kryepiskopi Anastas tha se pasi kemi shijuar dhe siguruar drejtimin drejt Perëndisë duhet që ta dëshmojmë këtë besim e ta japim këtë përvojë edhe tek të tjerët, duke theksuar rolin dhe mundësinë e sotme për ungjillëzim: “Kisha Orthodhokse ka si detyrë që të ungjillëzojë, dhe në shek. 21 provokimi për zhvillimin më të madh të Orthodhoksisë do të vijë nga 2 burime: nga drejtimi vertikal - ne me Perëndinë nga ku varet edhe thellësia e jetës murgërore dhe nga drejtimi horizontal - ne me njëri-tjetrin, duke dalë nga vetja jonë. Në këtë formë kryqi edhe Kisha e Rumanisë ka të gjitha mundësitë të jetojë këtë hapësirë të apostullimit, edhe në drejtim të Evropës së Bashkuar që pritet të jetë pjesëtare..., duke kujtuar edhe shembullin e Shën Nikodhimit, i cili u largua nga vendi i tij dhe erdhi këtu në Rumani, ai nuk lindi këtu. Ai jep një mesazh të gjallë tek kleri dhe populli rumun duke riorganizuar këtu edhe jetën murgërore.”

Të dielën, më datë 24, u celebrua Liturgjia Hyjnore Arkhieratike në sheshin jashtë manastirit, për arsye të mijëra e mijëra pelerinëve të ardhur për të marrë pjesë në kremtimet madhështore. Më parë u zhvillua litania e ikonës së shenjtit, shoqëruar me flamuj tradicionalë kishtarë (lavare), nga psaltët, nëndhjakonët, dhjakonët, priftërinjtë, episkopët, mitropolitët dhe primatët e Rumanisë dhe Shqipërisë. Ajo që e shtonte madhësinë e kremtimit, ishte edhe muzika bizantine që psalnin koret e të dy katedraleve, të Mitropolisë së Krajovës dhe Episkopatës së Tismanës, muzikë që jehonte në qetësinë rrëzës së Karpateve, të zonës së Gorshit, plot me gjelbërim, pyje dhe ujë të bollshëm, duke të të ngritur akoma më lart shpirtërisht.

Për herë të parë në këtë vend të Rumanisë u thanë në shqip thirrjet dhe lutjet nga Kryepi-

(vijon në faqen 8)

Një foto e përbashkët në Manastirin e Shën Nikodhimit të Tismanës.



(vijon nga faqja 7)

skopi Anastas, si edhe lutjet dhjakonore e fragmenti i Ungjillit të ditës: peshkimi i mrekullueshëm dhe dishepujt e parë. Pas komentit të shkurtër për fragmentin ungjillor, bërë nga Mitropolit i Kluzhit Bartolomeo, Kryepiskopi Anastas i shprehu përgëzimet e tij Patriarkut të Rumanisë Teoktist, Mitropolitit të Oltenias Teofan, si edhe të gjithë vëllezërve klerikë dhe gjithë besimtarëve të pranishëm. Pastaj Kryepiskopi theksoi rolin e apostujve në apostullimin e kombeve përtej Izraelit, sipas detyrës të ngarkuar nga Jisui, “*këtë gëzim të Ngjalljes nuk mund ta mbanin vetëm për vete, por duhet ta transmetonin kudo në botë. Edhe ne si Kishë Orthodhokse në tërësi nuk jemi muze i të vërtetave të besimit, por jemi pararoja dhe shpallja e besimit. Sot kemi bekimin që jemi mbledhur për të nderuar Shën Nikodhimin, i cili e jetoi gjallërisht Ungjillin e Krishtit, erdhi në një kohë të vështirë të kohës për të shpallur Ungjillin, ai erdhi në këtë vend duke kujtuar dhe imituar apostujt, duke rigjallëruar murgërinë*”. Në fund, Kryepiskopi tha se “*Për pak kohë Rumania do të hyjë si anëtare e Evropës së Bashkuar. Ajo nuk vjen në Evropë si e varfër, por si një vend i pasur me jetë shpirtërore, që është mjaft e domosdoshme në kohën e sotme për Evropën. Ndaj*

mos kini frikë në këtë hap të ri, sepse keni shumë për të dëshmuar për të vërtetën...”.

Më pas Patriarku Teoktist foli për ditën kremtuese dhe rëndësinë e saj historike “*...Për ne ky manastir është Sioni i Ri, sepse këtu rrezaton Shën Nikodhimi, i cili na lartëson tek thellësia dhe mendimi i Filokalisë me veprën e tij... këtu gjejmë faqe nga historia e hegjemonëve të Vllahisë, emrat e të cilëve përkujtuam në këtë Liturgji. Shenjti ishte një lidhje midis Orthodhoksisë së Malit të Shenjtë dhe të Ballkanit... në Moldavi, në Transilvani dhe kudo do të gjejmë frutat e veprës së Shën Nikodhimit. Dita e sotme na mbledh të gjithëve që të jetojmë vlerat e Orthodhoksisë sonë, ashtu siç dëgjuat edhe fjalën e Kryepiskopit Anastas, i cili është bariu i Kishës Orthodhokse të Shqipërisë, ku erdhën komunistët dhe e bënë shtet pa kisha, pa fe, pa besim dhe shkatërruan gjithçka fetare. Dhe erdhi Fortlumturia e Tij, që me hirin e Perëndisë, me veprën e tij apostolike bëri të mundur ringritjen e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë nga zeroja. Dhe prandaj Fortlumturia e Tij i Shenjtë iu foli me një mënyrë që mundën ta dëgjojnë edhe universitetet më të dëgjuara, madje atë mudi ta dëgjojë edhe Universiteti i Oksfordit. Fortlumturia është njeri i shkencës, jetoi fenë si*

prof. universiteti por dhe si hierark jeton përvojën e komunikimit me - Perëndinë.”

Në fund përshëndetën edhe përfaqësuesi i Presidentit të Republikës, si dhe i Ministrisë së Arsimit dhe Fesë. Pasi kungimi i popullit të shumë pjesëmarrës, që bashkë me priftërinjtë e zonës mbushën sheshin e madh. Ky aktivitet u pasqyrua edhe nga mediat kombëtare e lokale. Në fund të këtij aktiviteti 2-ditor kremtues u shtrua edhe dreka festive për të ftuarit e shumë.

Më datën 25 Kryepiskopi dhe ata që e shoqëronin u nisën drejt Bukureshtit, ku gjatë rrugës vizituan edhe disa manastire. Më pas u pritën nga Fortlumturia e Tij Teoktist në Selinë Patriarkale, ku u shtrua edhe një drekë, e më pas u përcollën për në aeroport.

Hierodhjakon Asti Bakallbashi

* *Kujtojmë që në nëntor 2003, delegacioni i Kishës sonë, i përbërë nga Kryepiskopi Anastas, Mitropolit Joan dhe klerikë të tjerë, kreu vizitën e parë zyrtare pas ringritjes nga themelet, në Kishën Orthodhokse të Rumanisë. Gjatë saj Kryepiskopi Anastas u nderua me medaljen dhe titullin akademik më të lartë të Fakultetit Teologjik të Universitetit të Bukureshtit “Dimitru Staniloae” dhe u dekorua nga Presidenti i Republikës së Rumanisë Iliesku. (shih “Ngjallja”, dhjetor 2003).*

E ardhmja e Shkollës së Konservimit dhe Restaurimit të Veprave të Artit

Zhvillimi i demokracisë në Shqipëri u krijoi mjaft mundësi të rinjve në drejtimit të kualifikimit të tyre. Për t'u ardhur në ndihmë të rinjve në zgjedhjen e profesioneve që dëshirojnë, në ditët e sotme janë hapur shumë shkolla të larta jo-publike të nivelit universitar dhe jouniversitar, që ofrojnë specializim në profesione të ndryshme.

Një shkollë e tillë është edhe Instituti 2-vjeçar i Formimit Profesional “Frymë Dashurie”, i hapur që nga viti 2000 me nismën, financimin dhe përkujdesjen e Fortlumturisë së Tij, Prof. Dr. Anastasit.

Kjo shkollë ka një profil të mirëfilltë profesional në disa degë, një nga të cilat është dhe dega e Konservimit - Restaurimit të veprave të artit dhe kërkimeve arkeologjike.

Hapja e kësaj dege lindi si domosdoshmëri për konservimin dhe restaurimin e pasurive kulturore në vendin tonë dhe është e para e

këtij lloji, duke plotësuar në këtë mënyrë një boshllëk në formimin e të rinjve në këtë sektor.

Restaurimi e konservimi i veprave të artit është një praktikë shumë antike, por që nga gjysma e dytë e shekullit të 20-të filloi të zhvillohej shumë shpejt si një shkencë e pavarur. Sistemi i studimeve në këtë degë, si në të gjitha degët e tjera që mbulon ky Institut, mbështetet në programe mësimore të standardeve europiane, gjë që pasqyrohet në planin mësimor të lëndëve që trajtohen gjatë dy viteve të tij.

Në përputhje të plotë me planin dhe programin mësimor, studentët janë të detyruar të ndjekin në mënyrë të vazhdueshme leksionet në auditor dhe punët praktike në një laborator bashkëkohor që funksionon pranë shkollës. Një tjetër avantazh për studentët e kësaj dege është që gjatë dy viteve të formimit të tyre, mund të punojnë në

laborator mbi vepra origjinale të epokës. Pas përfundimit të studimeve studentët paraqesin një punim të pavarur mbi temën e zgjedhur prej tyre.

Konservimi dhe restaurimi i veprave të artit dhe kërkimet arkeologjike janë një profesion i së ardhmes, sepse çdo ditë edhe më shumë qytetërimi ynë vlerëson rëndësinë e kulturës sonë dhe të veprave e objekteve antike, si edhe nevojën absolute të konservimit të tyre.

Shkolla për momentin është e specializuar në konservimin e druidhendjes, të pikturës në telajo të ikonave, të pikturës murale, të ndërthurura me konservimin e mozaikëve, qeramikës dhe letrës. Perspektiva e shkollës për vitet e ardhshme konsiston në specializimin për konservimin dhe kërkimet arkeologjike të metaleve, të qelqit, të letrës dhe tekstileve.

Në këtë degë japin mësim profesorë të huaj me përvojë dhe shumë

të njohur, që në të njëjtën kohë janë lektorë dhe në vende të tilla si Itali, Greqi, Angli etj., si edhe profesorë shqiptarë me përvojë dhe kualifikime jashtë shtetit.

Specialistët e diplomuar nga Instituti në këtë degë sot për sot kanë gjetur mundësi punësimi pranë Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, në studion e Restaurimit të pasurisë kulturore me vlera antike, si edhe në tregun privat të punësimit.

Por, si një profesion i së sotmes dhe i së ardhmes dhe në kushtet kur mjaft qytete muze si Butrinti, Gjirokastra, Berati me objektet, veprat dhe vlerat e tyre historiko-kulturore kanë fituar mbrojtjen e UNESCO-s, mundësitë e punësimit të brezave të ardhshëm të specialistëve të restaurimit dhe konservimit do të jenë edhe më të mëdha.

*Drejtoresh e Institutit
Prof. As. Dr. Beatrice Polo*

Manastire të krishtera që nuk ekzistojnë më në rajonin e Lushnjës

Myzeqeja, si një vend i begatë i Shqipërisë dhe me një të shkuar të shkëlqyer, siç shihet edhe nga qytetet që lulëzuan përreth saj, pati tërhequr vëmendjen që në kohët më të hershme e më vonë në mesjetë. U zhvillua një qytetërim i shënuar në qytete si Orikumi, Aulona, Amantia, Bylisi, Antipatria, Apolonia, Epidaurium, Epidamni, Dinali, Asparangjioni, Petra, Skampis etj., dhe në mesjetë prej Aulonës, Itea, Belegradi, Tomorum, Gradishta, Dyrahion, Taullandium, Cernikon e të tjera.

Ishte e kuptueshme të tërhiqte edhe vëmendjen e Kishës, dhe këtu u përhap në fillim krishterimi i ardhur prej Greqisë dhe prej Maqedonisë. Pra shohim të krijohen Horoepiskopi dhe episkopi të ndryshme për zhvillimin e krishterimit, si Episkopia e Apolonisë, e Bylisit, Kaninës, Vlorës, Amantias, Jerikos e Myzeqesë dhe e Shpatit, e Çernikut etj.

Të gjitha këto episkopi patën një aktivitet të mjaftueshëm për qytetërimin e banorëve të fushës dhe kodrinave përreth Myzeqesë dhe secila prej tyre përpigje si e si të krijonte manastire të mira, sepse në ato kohë që Shqipëria shkelej prej valësh barbare të ndryshme, manastiret e krishtera ishin si një dritë mes errësirës dhe kishin për qëllim të ndihmonin popullin me çdo mjet. Kështu i shonim manastiret e shenjta me murgjit e tyre jo vetëm t'i shërbenin popullit shpirtërisht, duke e afuar këtë me Zotin, po këto mbanin në mes të tyre shkolla diturie, biblioteka, infirmieri, spitale dhe ksenona (bujtinat), ku vizitoheshin dhe nevojtarët gjenin ndihmën e prehjen e tyre.

Rajoni i Lushnjës dikur ka pasur shumë manastire, prej të cilëve sot ka mbetur vetëm ai i Kadi Pashait, i mbiquajtur "Shën Todri" dhe ai i "Shën Marisë së Ardenicës", të tjerë mbetën si kisha enorish e dioqeze dhe të tjerë humbën krejt. Për disa rron ende gojëdhëna e tyre.

Unë këtu dua të bëj fjalë për ato manastire që nuk ekzistojnë sot; por gojëdhëna është ende e gjallë në gojën e popullit.



Kisha e manastirit të Shën Todrit, Kadi Pasha

Manastiri i Shën Savës në Lushnjë

Ky manastir siç duket ka qenë shumë i lulëzuar në mesjetë, pasi nga ai mori emrin edhe një lagje e qytetit të Lushnjës "Sarava", si edhe fusha e gjerë e Lushnjës u quajt, siç thonë, "Savra".

Gërmadhat e kishës së Shën Savës u zbuluan së fundi kur u instaluan refugjatët e ardhur nga Kosova. Tokë e cila u nda në pjesë dhe pjesa e kishës i ishte dhënë një familjeje, por si një truall i shenjtë, familja nuk bëri ondi në këtë vend, se kur donte të bënte shtëpinë, gjeti themelet e vakëfit dhe e abandonoi tokën.

Kjo tokë, kur u ndalua prej qeverisë varrimi në qytet i të vdekur-

ve, iu dhurua prej saj komunitetit Orthodhoks të Lushnjës, por ai preferoi më mirë Golemin sesa Saraveun, sepse si fushë kishte baltë dhe në kohë të keqe nuk do të mundte t'i varrose të vdekurit, dhe nuk kishin mjetet e duhura që të bënin paraklisin e rrethimin e saj.

Kisha e Madhe ose Kisha e Kuqe në Lushnjë

Mbi malin e Gurit në Lushnjë, ku nxjerrin gurët për ndërtesat e udhët e qytetit, ka një fushë të vogël, mbi të cilën thuhet se në kohërat e moçme ishte një kishë e madhe dhe e ndërtuar me tulla e qeramidhe të kuqe. Për këtë edhe ky vend sot ku kullosin kafshët mbiemërohet "Kisha e Madhe ose Kisha e Kuqe". Gjithashtu më të

moshuarit thonë se këtu, përreth kishës, ka pasur shumë konakë (banesa) ku banonin murgjit.

Nga brinja e majtë e kësaj kodre, nga ana e Lushnjës, gjenden varre të vjetër. Vendi i Kishës së Kuqe i ishte dhënë në fillim komunitetit Orthodhoks, për të ndërtuar kishën famulltare, por këta, meqë ishte shumë larg qendrës dhe në majë të kodrës, nuk e pranuan dhe blenë vendin e kishës së Shën e Premtes, ku e rindërtuan këtë faltore para dyqind e pesëdhjetë vjetësh.

Manastiri i Shën Kollit në Karbunarë

Katundi i Karbunarës në fillim banohej vetëm prej të krishterëve dhe në ato kohëra kishte një manastir me emrin e lavdueshëm të Shën Kollit. Me ardhjen e turqve, në këto vise, pas luftimeve të ashpra që u zhvilluan ndërmjet fisit të Balshajve dhe turqve, si edhe ndërmjet Gjergj Kastriotit e turqve e me zotërimin e këtyre të fundit në gjithë Myzeqenë, ky manastir u kthye dhe u bë teqe, sot teqeja e Karbunarës...

Pas prishjes së manastirit të krishterët e Stanit të Karbunarës ngritën në majë kishëzën e Shën Kollit, që të mos harrohet kujtimi i manastirit të moçëm. Po edhe kjo kishë u dogj prej keqbërësve.

"Jeta Kristiane" 1944

Dh. Beduli



Ikonostasi i Manastirit të Shën Nikollës, Boboshticë. Ky fshat nuk dallohet vetëm për traditën dhe kishat historike, por edhe për kujdesin dhe interesin e treguar nga besimtarët, të cilët kanë bërë të mundur jo vetëm riparimin e mjaft prej tyre, por edhe ngritjen e kishave të reja.

Ata që punuan për Kishën tonë

Brezat e priftërinjve të familjes Ikonomi, nga Ziçishti i Devollit

Familja Ikonomi është dalluar që nga shekulli i 19-të, si familje që ka nxjerrë disa breza priftërinjsh, traditë që vazhdon deri më sot. I pari, atë Pavlo, u lind në vitin 1860 dhe ka fjetur më 1931. Pasi mbaroi shkollën e mesme "Zosimea", në Selanik të Greqisë, erdhi në Shqipëri rreth vitit 1880, në fshatin Gjyres të Devollit të Sipërm, si mësues i gjuhës greke. Pas 10 vjetësh u transferua në fshatin tonë, Ziçisht, po mësues, ku edhe u martua. U dorëzua prift në Mitropolinë e Kosturit. Bashkë me bashkëshorten e tij lindën, rritën dhe i edukuan me mësimet e fesë orthodhokse 3 fëmijët e tyre. Njëri prej tyre, Dhimitri, duke parë dhuntinë shpirtërore, ndoqi traditën e të atit dhe në vitin 1932 u hirotonis në Mitropolinë e Korçës. Para se të bëhej prift, atë Dhimitri ka punuar marangoz në Korçë, por edhe psalt nga më të mirët, se kish një zë të bukur e melodioz dhe zotëronte edhe muzikën kishtare bizantine. Ikonom Dhimitri ishte patriot fanolist antigogist. Kur festohej dita e ngritjes së flamurit shkonte në qendrën e



Atë Pavlo Konomi (Sotiri)

Komunës në Bozhigrad, që ka disa vite që është emërtuar, Miras, ku mbante fjalimin. Por vdiq shpejt, pas 10 vjetëve si prift, në vitin 1942, por kujtohet nga të moshuarit, jo vetëm në Korçë, por edhe në gjithë fshatrat e Devollit. Kishte lidhje miqësore të afërta edhe me klerikë myslimanë, disa prej të cilëve i kishte miq që e vizitonin jo vetëm në shtëpinë e tij, por vinin edhe në kishën kryesore të fshatit tonë, të Shën Marisë.

Brezi i tretë ishte atë Sotir Konomi. Edhe ky punonte marangoz në Korçë, në kohën e Zogut. Bënte pjesë edhe në korin karakteristik "Lira". Edhe ai mbaroi "Zosimënë" në Selanik dhe në Janinë të Greqisë dhe u hirotonis prift në prill të vitit, 1949, në Mitropolinë e



Atë Dhimitër Pavlo Konomi

Korçës. Atë Sotiri ka qenë fanolist dhe u afrua me Luftën Nacionalçlirimtare. Atë Sotiri shërbeu me devotshmëri si prift, por pa harruar edhe zanatin e marangozit, duke i mirëmbajtur katër kishat që ka fshati. Ai shërbeu gjer në vitin 1967, kur me urdhër të qeverisë komuniste u mbyllën të gjitha objektet e kultit.

Por tradita nuk u ndërpre. Në vitin 1993, djali i vogël i atë Sotirit, Viktori, mbasi kreu Seminarin Orthodhoks në një godinë të plazhit të Durrësit, u dorëzua e u hirotonis prift nga të parët në Shqipëri, këtu në Tiranë, në Kishën e Ungjillëzimit, nga Kryepiskopi ynë i nderuar Anastasi.

Av. Pandi Sotir Konomi

*Adresat e faqeve në Internet dhe ajo
e E-mailit, të Kishës Orthodhokse Autoqefale
të Shqipërisë, janë:*

Internet: www.orthodoxalbania.org
E-mail: orthchal@orthodoxalbania.org

Kalendari i Liturgjive Hyjnore, NËNTOR 2006

1 E Mërkurë + Anargj.
Kozma e Damian nga Azia.
Dësh. i ri Jakovi etj.
4 E Shtunë + Osh. Joaniqi.
Hierod. Nikandri i Mirës.
Porfir gaztari.

5 E DIEL + 5 LLUKAIT.

Ap. Hermai, Lini etj. Dësh.
Galaktioni, Epistima.
8 E Mërkurë + Kryeengjëjt
Mihail e Gavriil dhe Fuqitë
e Patrup.
9 E Enjte + Nektari i
Pentapojës. Dësh. Onisifori,
Porfiri. Oshg. Theoktista.
11 E Shtunë + Dësh. Minai,
Viktori, Vicenti, Stefanidha.
Osh. Theodhor Studhiti.

12 E DIEL + 8 LLUKAIT.

Joan Përdëllimtari i
Aleksandrisë. Osh. Nil
mirovli.
13 E Hënë + Joan Gojarti
i Kon/pojës. Oshd. i ri
Damaskini.
15 E Mërkurë Dësh. Guria,
Samonai, Avivi. Osh. Pais
Velickofski.
(*Fillon Kreshma.*)
16 E Enjte + Ap. dhe
Ungjillor Mateu. Dëshg.
Ifigjenia.
18 E Shtunë + Dësh. Platoni,
Romani. Dësh. i ri Anastasi
nga Paramithia.

19 E DIEL + 9 LLUKAIT.

Pr. Abdiu. Dësh. Varlaami,
Iliodhori. Dësh. Azi.
**21 E MARTË + # Hyrja
në tempull e Hyjlindëses
Mari.** Osh. Sozomeni.
25 E Shtunë + Mbyllja e
Hyrjes në tempull të
Hyjlindëses. Dëshmg.
Ekaterina. Dësh. Mërkuri.

26 E DIEL + 13

LLUKAIT. Osh. Alipi,
Stilian paflagoni, Nikoni
"pendohuni".
30 E Enjte + Ap. Andrea,
i parëthirruri. Frumenti
i Etiopisë.



NGJALLJA

Organ i Kishës Orthodhokse
Autoqefale të Shqipërisë

Themelues:
Kryepiskopi Anastas

Del nën kujdesin
e Këshillit Botues

Kryeredaktor: Thoma Dhima

Adresa:
Kryepiskopata Orthodhokse,
Rruga e Kavajës, Nr. 151
Tiranë
Tel: (042) 34-117, 35-095.
Fax: 32-109
Shtypur në shtypshkronjën
"Ngjallja"

Filluan Përkujdesjet Ditore të Kishës



Në shtator rinisën nga funksionimi 15 përkujdesjet ditore të fëmijëve, të cilave u shtohet kopshti më i ri, ai i Dervicianit.

Duhet veçuar këtu risitë në kopshtet e Tiranës dhe Durrësit. Kopshtit të kryeqytetit iu shtuan mjedise të reja dhe një kuzhinë model, që do bëjnë të mundur kalimin në sistemin “me drekë” të një pjese të fëmijëve.

Ndërsa kopshti i Durrësit sivjet u vendos në mjedise plotësisht të reja dhe me kushte bashkëkohore. Gjithashtu, edhe ky kopsht do të kalojë në sistemin me drekë.

Ëndrra që u bë realitet

Është kënaqësi të punosh me fëmijët; ata janë të mrekullueshëm e çapkënë... Por më kënaqësi është t'u dhurosh atyre dashuri dhe përkujdesje; cilësi këto që çdo edukatore duhet t'i ketë. Por fëmijët kanë kërkesa; disa na i thonë e ne mundohemi t'i realizojmë, por disa të tjera edhe i ruajnë për vete. Ndërsa disa të tjera, pavarësisht, nga dëshira jonë e mirë nuk mundemi t'ua realizojmë.

Gjatë gjithë këtyre viteve pune me fëmijët ruaj shumë kujtime dhe mbresa të bukura. Kam dëshiruar e dëshiroj gjithmonë të futem në botën e tyre që të di dhe të realizoj sado pak ëndrrat e tyre të mrekullueshme. Bota e tyre është mrekulli si vetë ata... Lum kush e ka këtë fat!

Por një mrekulli është edhe kopshti ynë. Ai u bë realitet falë shpirtit hyjnor të Kryepiskopit tonë, Anastasit, dora e ngrohtë e të cilit është ndjerë në shumë akte bamirësie. Ti reshtosh ato do duhen tërë faqet e gazetës dhe shumë kohë.

Ne edukatoret e kopshtit të Tiranës kemi kohë që i gëzohemi kopshtit të ri. Më vonë ai do mbushet me fëmijë e do të bëhet edhe më i bukur. Ata do lumturohen nga kopshti i tyre i ri: duke realizuar ëndrrën e tyre.

Tani që po shkruaj këto radhë jam në ambientet e tij të bukura e të bollshme dhe nga koleget e mia dhe prindër të ndryshëm dëgjoj të thonë: “Sa mirë dhe sa shpejt u ndërtua..., faleminderit Kryepiskopit tonë të nderuar”.

Këto janë fjalët që dalin nga zemra jonë, nga ajo e prindërve dhe e fëmijëve të tyre.

Edhe një herë faleminderit dhe jetë të gjatë Fortlumturi, për të mirën e Ordhohoksisë shqiptare.

*Me përrulësi, dashuri
dhe mirënjohje,*

Janulla Toslluku

Foto -lajm



Greqi - Një prift orthodhoks mban në duar ikonën e së Tërëshenjtës në Manastirin e Elonas, afër qytetit Leonidhio, 300 km në jugperëndim të Athinës. Ikona, e shek. XIV, e nderuar veçanërisht nga besimtarët, së cilës i atribuohen shumë mrekulli, u gjet nga policia pasi ishte vjedhur më 18 gusht.



Palestinë - Një prift orthodhoks arab po shqyrton dëmet e shkaktuara në një Kishë të djegur orthodhokse në Tulkarem, Bregu Perëndimor, në shtator. Kisha prej guri, e ndërtuar rreth 2 shekuj më parë, u shkatërrua dhe u dogj pas protestave të myslimanëve për një fjalim të papës, protesta që goditën mjaft objekte të krishtera, pavarësisht se kujt i përkisnin.

Tiranë

Takim për forcimin dhe promovimin e bashkëjetesës fetare

Nga 29 shtatori deri më 1 tetor, në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar u zhvillua seminari me temë: "Forcimi dhe promovimi i bashkëjetesës dhe tolerancës, për një shoqëri më të sigurtë në Ballkan e më gjerë". Takimi organizohej nga "NATO Science for Peace Project". Në të ishin ftuar studiues dhe personalitete të shquara nga vendi dhe rajoni por edhe më gjerë.

I ftuar të mbante kumtesë ishte edhe Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Prof. Dr. Anastasi, i cili mbajti temën: "Drejt një bashkëjetese të qëndrueshme e paqësore në Ballkan". Pikat në të cilat u përqendrua në fjalimin e tij ishin: 1. Forcimi i harmonisë së bashkekzistencës ndërmjet komuniteteve fetare, 2. Mbikalimi i çdo lloj dhune, rivlerësimi i kuptimit dhe rëndësisë së atdhetarizmit, 3. Përpyekja për pajtim të vërtetë dhe paqe të qëndrueshme.

Tema me interes u mbajtën dhe nga folës të ndryshëm, përfaqësues të komuniteteve të tjera fetare, si i z. Ermir Gjinishi, i

Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, i episkopit ndihmës të Dioqezës Tiranë, Durrës të Kishës Katolike, Georges Frenco dhe për Vëllazërinë Ungjillore në Shqipëri z. Fitor Muça. Gjithashtu, i pranishëm gjatë gjithë seancave ishte dhe ish-presidenti i Shqipërisë z. Rexhep Meidani, i cili mbajti kumtesën "Përplasja e qytetërimeve – një paradoks apo një realitet!? Modeli pozitiv shqiptar". Gjithashtu kumtesë u mbajt dhe nga z. Arbër Xhaferri, të ftuar nga Greqia, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Serbia, Italia etj.

Pothuajse nga të gjithë folësit u përmend shembulli i mirë dhe i rrallë i harmonisë dhe tolerancës fetare që ka ekzistuar dhe vazhdon të jetë në vendin tonë. Gjithashtu u tërhoq vëmendja për dukuritë e reja që paraqiten dhe përballet sot njerëzimi dhe sigurisht edhe vendi ynë dhe nevoja e ballafaqimit dhe e kapërcimit të tyre.

Takimi u pasqyrua dhe nga mediat e vendit, të pranishme gjatë ditëve të zhvillimit të seminarit.

A. A.

Veprimtari ndërfaqetare në Londër



Nga 10-17 shtator, në Londër u zhvillua një veprimtari e organizuar nga "World Learning" dhe USAID, për shkëmbimin e përvojës mes organizmave dhe shoqatave ndërfaqetare lokale të Londrës me përfaqësues zyrtarë nga të 4 komunitetet fetare të Shqipërisë. Mori pjesë dhe një përfaqësues i Komitetit të Kulteve. Kisha jonë u përfaqësua nga 3 klerikë. Takimi u zhvillua në një atmosferë të ngrohtë dhe miqësore, ku edhe njëherë u pa nevoja e ketyre lloj kontaktesh që krijojnë mundësinë e shkëmbimit të përvojës.

Përvojë pozitive me kampet e fëmijëve

Këtë verë ashtu si edhe 5 vitet e shkuara, Kisha jonë, nëpërmjet Zyrës së Fëmijëve, në bashkëpunim me atë të Katekizmit dhe me të rinj nga grupet rinore orthodhokse, organizoi kampet ditore për fëmijë.

Këtë vit u përzgjodh për t'u përcjellë tek fëmijët te-

ma: "Të mësojmë nga shenjtoret". Këto kampet u organizuan në 28 qytete e fshatra në të gjithë vendin.

Programi i tyre përmbante: Lutjen e mëngjesit, këngë, vargun e ditës, mësim, punëdore, lojëra të ndryshme, lutjen e mbylljes etj.

Programi i çdo kampi zgjat 7 ditë. Si gjithmonë, dita e fundit është mbyllja e veprimtarisë. Në këtë ditë u organizuan festivale, ku qenë të ftuar prindërit, të cilët mund të shikonin ato gjëra që fëmijët kishin mësuar përgjatë kampit.

Në vendet ku u zhvilluan kampet, si në Kavajë, Durrës, Bubullimë, Lushnjë, Elbasan, Shën Joan Vladimir dhe Fikas, nga vizitat dhe bisedat me koordinatorët përkatës të

kampeve rezultoi se ato janë të dobishme, sepse fëmijët zbavitën dhe përdorin në mënyrë aktive kohën e tyre të lirë, si edhe ajo që është më e rëndësishme, mësojnë për Perëndinë përgjatë një kohe ku ky mësim ofrohet më intensivisht në disa zona dhe për herë të parë në disa vende të tjera. Këto kampet ndihmojnë shumë për afrimin e sa më shumë fëmijëve pranë Kishës dhe aktiviteteve të saj.

Edhe për vitin shkollor në vazhdim Zyra Kombëtare e Fëmijëve ka planifikuar një sërë aktivitete të larmishme.

Gabriela Bezhani
Ana Kërçuku

Biseda shpirtërore me gratë orthodhokse

Nisën bisedat shpirtërore me gratë orthodhokse të kryeqytetit. I ftuar në takim e parë në kishën "Ungjillëzimi i Perëndilindësës" në Tiranë ishte Hirësi Ilia Ketrë, drejtor i Akademisë Teologjike në Shën Vlash. Në një bisedë të ngrohtë familjare, Imzot Ilia bëri urimet e rastit për një vit të bekuar në mënyrë që gratë të vijnë të jenë aktive në jetën dhe zhvillimin e mëtejshëm të Kishës. "Për të ecur në hapat e apostujve, duhet që

gjithçka të bëhet me Hirin e Perëndisë. Në çdo punë duhet të kujtojmë Zotin që Ai ta bekojë dhe ta shenjtërojë jetën tonë" - theksoi ai. Takimi shpirtëror do të vijojë çdo të mërkurë në orën 16⁰⁰ në kishën e "Ungjillëzimit" në Tiranë ku marrin pjesë rreth 50 gra, të cilat përmes diskutimeve me tematika shpirtërore dhe sociale njihen me besimin orthodhoks. Gjatë këtij viti do të referojnë çdo javë teologë dhe pedagogë të Akademisë Teologjike.